

Sigurimi i depozitave dhe skemat e sigurimit

Dr. Elvin MEKA

10

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Pse krijohen skemat e sigurimit të depozitave?


Skemat e sigurimit të depozitave krijohen dhe janë pjesë e RRJETËS SË SIGURISË (*safety net*), që çdo sistem financiar krijon, me qëllim shmangien e rrezikut të dështimit të sistemit (systemic risk) dhe sigurimin e një stabiliteti afatgjatë të tij.

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Pse krijohen skemat e sigurimit të depozitave?


Skemat e sigurimit të depozitave konsiderohen si pjesë e rregullimit të sistemit bankar dhe masave për sigurimin e stabilitetit të këtij sistemi.



Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

*Skemat e sigurimit të depozitave
si pjesë e rrjetës së sigurisë*



Skemat e sigurimit të depozitave si pjesë e rrjetës së sigurisë

- 1. Rregullimi dhe mbikëqyrja e sistemit,**
- 2. Huadhënësi i shpresës së fundit (banka qendrore ose shteti),**
- 3. Baza efektive rregullatore për falimentimin ose likuidimin e bankave,**
- 4. Skemë solide e sigurimit të depozitave,**
- 5. Bashkëpunim dhe vendimarrje e institucionalizuar midis institucioneve të ndryshme të sistemit.**

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Skemat e sigurimit të depozitave si pjesë e rrjetës së sigurisë

Bankingu si aktivitet ekonomik specifik (si aktivitet besimi) dhe që përdor gjerësisht levën financiare mund të ekspozohet shumë shpejt ndaj efekteve negative domino (spillover – contagion), që rezultojnë pas problemeve të likuiditetit që mund të ketë një bankë e vetme në sistem.

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Skemat e sigurimit të depozitave si pjesë e rrjetës së sigurisë

Problemet e likuiditetit që mund të ketë një bankë e caktuar në sistem mund të çojnë në:

- 1. Tërheqje masive të depozitave në atë bankë (BANK RUN),**
- 2. Tërheqje masive të depozitave në të gjithë bankat - panik bankar (BANK PANIC).**

BANK RUN ≠ BANK PANIC

Skemat e sigurimit të depozitave si pjesë e rrjetës së sigurisë

“*Bank run*” në një bankë jo domosdoshmërisht mund të shkaktojë panik bankar. Gjithsesi kalimi nga “*bank run*” në panik bankar është tepër i lehtë të ndodhë, pasi:

- **Klientët mund të perceptojnë që banka me probleme vuan nga probleme sistemike, që mund të shfaqen dhe në banka të tjera,**
- **Asimetria e informacionit që karakterizon klientët, kushtëzon klientin të reagojë duke tërhequr depozitat dhe nga bankat e shëndosha, sesa të monitorojë cilësinë e aktivitetit bankar.**

Qëllimet e skemës së sigurimit të depozitave

Skemat e sigurimit të depozitave kanë dy qëllime kryesore:

- 1. Të parandalojë “*bank run*” në institucionin depozitues jolikuid, por solvent, duke evituar përhapjen e krizës në sistem (sigurimi i stabilitetit të sistemit);**
- 2. Të minimizojë dhe kompensojë deri në një masë të caktuar dëmet dhe humbjet e shkaktuara klientëve nga ky institucion me probleme (mbrojtje të konsumatorit).**

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Qëllimet e skemës së sigurimit të depozitave

Skemat e sigurimit të depozitave synon:

- 1. Parandalimin e rrënimit të institucioneve depozituese jolikuide, por solvente, përmes masave të përshtatshme lehtësuese, në koordinim me autoritetet mbikëqyrëse dhe bankën qendrore;**
- 2. Sigurimin e pagimit të shpejtë dhe të plotë të depozitave të siguruara në rastin të ndodhjes së një ngjarje të tillë, dhe ndihmon në likuidimin e kontrolluar e të kujdesshëm të institucioneve financiare josolvente,**
- 3. Rritjen e stabilitetit e sistemit tëndërmjeësimit financiar.**

Funksionet e skemës së sigurimit të depozitave

Skemat e sigurimit të depozitave duhet të plotësojë 5 funksione:

- 1. Funkzioni i Besimit: Skema përmes ekzistencës së saj, krijon besim midis të depozituesve në stabilitetin e institucioneve ku ata depozitojnë dhe në gjithë sistemin financiar.**
- 2. Funkzioni i Mbrojtjes: Mbron depozituesit në rast krize, ndaj humbjeve të depozitave të tyre të siguruara. Tërthorazi skema siguron dhe mbrojtjen e institucioneve të siguruara dhe sistemit financiar ndaj fenomenit “bank run” dhe panikut bankar.**

Funksionet e skemës së sigurimit të depozitave

Skemat e sigurimit të depozitave duhet të plotësojë 5 funksione:

- 3. Funkzioni i Sigurisë: Skema i siguron depozitat e mbuluara me sigurim prej abuzimit dhe posedimit të tyre nga grupet e tjera të interesit në bankë.**
- 4. Funkzioni Financimit: Skema duhet të garantojë së ka kapitalizim të mjaftueshëm për të kryer funksionet e mbrojtjes dhe të sigurisë së depozitave të klientëve. Kjo mundëson likuiditetin e mjaftueshëm për të mbuluar depozitat e siguruara në rast krize.**

Funksionet e skemës së sigurimit të depozitave

Skemat e sigurimit të depozitave duhet të plotësojë 5 funksione:

5. Funkzioni Mbështetës: Së fundi, skema e sigurimit të depozitave mbështet dhe institucionet e tjera financiare që garantojnë rrjetën e sigurisë, në kuadër të sigurimit dhe përmirësimit të stabilitetit të sistemit financiar.

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Historiku i Skemave të sigurimit të depozitave

Historikisht, skemat e sigurimit të depozitave janë krijuar pas krizave të mëdha financiare, apo ndonjë paniku bankar.

Skemat e para të sigurimit të depozitave janë krijuar në Evropë rreth viteve '20 të shek. XX si sipërmarrje private (çekosllovaki dhe Austri.

Skema e parë zyrtare shtetërore është krijuar në SHBA, FDIC (Federal Deposit Insurance Corporation) në 1933, pas Depresionit të Madh.

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Historiku i Skemave të sigurimit të depozitave

FDIC (Federal Deposit Insurance Corporation),
1933

FDIC është institucion me attribute mbikëqyrëse në sistemin bankar amerikan, përveç aspektit të sigurimit të depozitave.

FSLIC (Federal Savings and Loan Insurance Corporation)
1934

Siguron depozitat nga shoqëritë e kursim kreditit.

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Historiku i Skemave të sigurimit të depozitave

Skemat Evropiane

Kryesisht të zhvilluara në vitet '70 në Gjermani, Itali, Belgjikë etj.

Vetëm në vitin 1994, BE miraton Direktivën 94/19/EC mbi skemat e sigurimit të depozitave, duke krijuar kuadrin e parë ligjor që synonte harmonizimin e skemave të sigurimit të depozitave në shtetet anëtare të BE.

Skemat e sigurimit të depozitave

Llojet e garancive


Skemat e sigurimit të depozitave ofrojnë garanci të shprehura (explicit) dhe/ose të nënkuptuara (implicit).

Të gjitha skemat në fuqi ofrojnë garanci të shprehur, ndërkohë që garancitë e nënkuptuara formësohen në zbatim të parimit “too big to fail”.

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Arkitektura e Skemës së sigurimit të depozitave




Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Llojet e Skemave të sigurimit të depozitave

Skemat e sigurimit të depozitave mund të organizohen sipas 4 modeleve:



Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Llojet e Skemave të sigurimit të depozitave

Skemat e sigurimit të depozitave mund të organizohen sipas 4 modeleve:

- 1. PAY BOX: SSD kufizohet vetëm në pagesën e depozitave të siguruara.**
- 2. COST REDUCER: Përveç funksionit të PAY BOX, SSD ka të drejtë të ndërhyjë në institucionin depozitues me probleme. Duke marrë masa korrektuese dhe parandaluese, për të mbrojtur depozitat e siguruara.**

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Llojet e Skemave të sigurimit të depozitave

Skemat e sigurimit të depozitave mund të organizohen sipas 4 modeleve:

3. RESOLUTION FACILITATOR: SSD merr një rol proaktiv në lidhje me institucionin depozitues me probleme (duke e strukturuar, shitur këtë institucion tek banka të tjera apo ta rikapitalizojë atë).

4. SUPERVISOR: SSD është pjesë e autoriteteve mbikëqyrëse.

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Financimi i Skemave të sigurimit të depozitave

Depozitat që sigurohen vs. depozitave të mbuluara me sigurim.

Skemat e sigurimit të depozitave përgjithësisht mbulojnë depozitat e kursimit dhe ato me afat të individëve dhe të bizneseve (por jo at të institucioneve financiare) (eligible deposits).

Përgjithësisht depozitat e klientëve biznes nuk janë pjesë e sigurimit të depozitave.

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Financimi i Skemave të sigurimit të depozitave

***Depozitat që pranohen për sigurim vs.
depozitave të mbuluara me sigurim.***


Depozitat që pranohen për sigurim (eligible deposits) mbulohen me sigurim deri në një masë të caktuar (psh: 100,000\$ ose 100,000€).

Këto quhen depozita të mbuluara me sigurim (covered deposits).

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Financimi i Skemave të sigurimit të depozitave



Skemat e sigurimit të depozitave - Financimi

Skemat e sigurimit të depozitave mund të ndërtohen sipas dy modeleve të financimit:

1. EX – ANTE

Sipas këtij modeli, institucionet depozituese paguajnë paraprakisht një prim sigurimi. Shumica e SSD-ve janë të modelit EX-ANTE.

2. EX – POST

Sipas këtij modeli, institucionet depozituese paguajnë kontribute ndaj SSD, pas ndodhjes së një falimentimi apo likuidimi bankar.

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Skemat e sigurimit të depozitave -Financimi

	Advantages	Disadvantages
Ex-post	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Market discipline</i>: Induces banks to monitor each other's activities. 	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Potential payout-delays</i>: The funds are not collected beforehand. • <i>Procyclical effects</i>: Commitments in poor economic situations may lead to a domino effect of bank failures, a renegotiation of conditions and/or a collapse of the DIS.
Ex-ante	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Public confidence</i>: Prompt reimbursement of depositors possible. • <i>Smoothed premium payments</i>: Reduced procyclical effects. • <i>Reduced moral hazard</i>: Ex-ante funding could incorporate risk-adjusted premiums. • <i>Equitable and fair</i>: All member institutions (including prospective failed institutions) contribute. 	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Adequate fund-size</i>: Difficult to establish a fund of sufficient size. • <i>Adequate premium calculation</i>: Difficulties in defining a 'fair' calculation method. • <i>Administrative complexity</i>: Organizational and strategic intricacy.

Financimi fillestar i skemave të sigurimit të depozitave

Skemat e sigurimit të depozitave e sigurojnë financimin fillestar dhe në vijim nga:

- a) Garancitë shtetërore (qeveria/banka qendrore),**
- b) Kontributi i qeverisë si kapital fillestar,**
- c) Kontributi fillestar nga institucionet e siguruara**
- d) Kontributet/primet nga institucionet e siguruara,**
- e) Emetimi i letrave me vlerë (obligacione),**
- f) Kombinim i skemës ex-ante me ex-post.**

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Financimi fillestar i skemave të sigurimit të depozitave

Kontributet ose primet e sigurimit të depozitave janë:

a) Prime të barabarta / fikse (flat premium):

Çdo institucion depozitues paguan një madhësi të barabartë primi sigurimi (në %).

b) Prime të bazuara në shkallën e rrezikut të institucionit depozitues (risk-based).

Çdo institucion depozitues paguan një madhësi të caktuar primi sigurimi, në varësi të shkallës së përlogaritur të rrezikut.

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Financimi fillestar i skemave të sigurimit të depozitave

Në SSD me prime të bazuara në shkallën e rrezikut të institucionit depozitues, kjo shkallë përlllogaritet sipas sistemit klasifikues CAMELS.

CAMELS

CAPITAL ADEQUACY (mjaftueshmëria e kapitalit)

ASSET QUALITY (Cilësia e aktiveve)

MANAGEMENT (Manaxhimi)

EARNINGS (Të ardhurat)


LIQUIDITY (Likuiditeti)

SENSITIVITY (Ndjeshmëria)

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Skemat e sigurimit të depozitave në BE - 2008



Financimi fillestar i skemave të sigurimit të depozitave

Pagesa e depozituesve

Kur një institucion depozitues i siguruar falimenton, SSD i siguron depozituesve të këtij institucioni akses të shpejtë në fondet e siguruara, pasi vetëm kështu ruhet besimi dhe stabiliteti në sektorin bankar dhe sistemin financiar.

Funksioni bazë këtu është rimbursimi i shpejtë i depozituesve sipas ligjit.

Këtu plotësohen një sërë kushtesh ligjore, financiare dhe administrative.

Sigurimi i Depozitave dhe Skemat e Sigurimit

10

Skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri - ASD

Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) vepron në Shqipëri që nga Tetori i vitit 2002. Objektivi kryesor i veprimtarisë së saj është sigurimi dhe kompensimi i depozitave të individëve në sistemin bankar, si edhe kontributi në stabilitetin e sistemit financiar të vendit.

ASD u krijua sipas Ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave“, i ndryshuar me Ligjin nr. 10 106, datë 30.03.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave“.

Skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri – ASD - Karakteristikat kryesore

- **Sipas modelit PAY BOX,**
- **Prim sigurimi të njëjtë (flat premium) (0.5% e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara që janë regjistruar në bankë në fund të çdo dite pune të tremujorit të fundit të vitit të shkuar),**
- **Kufiri i sigurimit: 2,500,000 Lekë (100%), dhe pa bashkësigurim (co-insurance).**
- **Fondi themeltar i Agjencisë është 400 000 000 (katërqind milionë) lekë, kontribut i buxhetit të shtetit.**